



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

Nr. 2724 prot.

Tiranë, më 14 .05 .2024

**SHPALLJEN E THIRRJES PËR APLIKIM SI ANËTAR EKSPERT NGA
SHOQËRIA CIVILE NË KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË
PROJEKTPROPOZIMEVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR
FONDET GRANT PËR RININË**

Në zbatim të Ligjit Nr. 75/2019 “Për Rininë” dhe vendimit nr.566, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët shpall thirrjen për aplikim si anëtar ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projekt-propozimeve të paraqitura nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë në thirrjen e IV të AKR-së.

Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve:

Procesi i përzgjedhjes së anëtarët ekspert dhe dy anëtarëve rezervë, në rast krijimi të vakancës, nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projekt-propozimeve do të menaxhohet nga Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe do të bazohet në një proces të hapur konkurrimi. Përzgjedhja e aplikantëve do të bazohet mbi vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të shpallura në këtë thirrje.

Kriteret e aplikimit:

Anëtari ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projekt-propozimeve, duhet të plotësojë kushtet mëposhtme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare “master” për drejtësi, administrim publik, shkenca ekonomike apo shkenca shoqërore;
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune;
- Të ketë përvojë të mëparshme në vlerësimin e projektpropozimeve të organizatave të shoqërisë civile në thirrje konkurruese për financim;

-Të ketë përvojë në përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe/ose vlerësimin e projekt-propozimeve të financuara me fonde publike;

- Të ketë njohuri në fushën e politikave dhe çështjeve rinore;

Procesi i aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë me email në adresën rinia@kryeministria.al dokumentacionin, si vijon:

1. Jetëshkrimin në gjuhën shqipe ku të përfshihen të dhënat e arsimimit dhe të gjitha eksperiencat e lidhura me fushën;
2. Një letër motivimi në gjuhën shqipe;
3. Formular vetë deklarimi për autenticitetin e të dhënave sipas formatit bashkëlidhur;
4. Kopje të diplomës.

Në rast përzgjedhje kandidati duhet të dërgojë me email edhe:

1. Kopje të dokumentit të identifikimit;
2. Dëshmi Penaliteti;

Afati i aplikimit:

Afati përfundimtar i dorëzimit të aplikimit është data 18.05.2024.

Periudha e zbatimit të detyrave:

Maj – Qershor 2024

Informacion shtesë:

Angazhimi i anëtarit ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projekt-propozimeve të të paraqitura nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë bëhet pa pagesë.

Anëtari ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit ushtron detyrën në përputhje me kuadrin rregullator të miratuar për thirrjen dhe i nënshtrohet detyrimeve ligjore të përcaktuara për konfliktin e interesit dhe konfidencialitetit të dhënave gjatë gjithë procesit.

MINISTRI

